Programet për Dhunuesit në Ballkanin Perëndimor

Shqyrtimi i Praktikave Ekzistuese dhe i Mënyrave për të Ecur Përpara

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova*

Funded by
the European Union

www.work-with-perpetrators.eu

UN WOMEN

Programet për Dhunuesit në Ballkanin Perëndimor;
Shqyrtimi i Praktikave Ekzistuese dhe i Mënyrave për të Ecur Përpara

Autorët: Sandra Jovanović Belotić
Berta Vall

Citimi i sugjeruar: Jovanović, S. & Vall, B. (2022). *Perpetrator Programmes in the Western Balkans; Mapping the Existing Practices and Ways Forward. Executive summary. Kosovo.* Berlin: The European Network for the Work With Perpetrators of Domestic Violence (WWP EN).

Redaktor: Irena Znidaršić Trbojević
Dizenjues Grafik: Monika Medvey

© 2022, Rrjeti Evropian për Punën me Dhunuesit
Leunaer Straße 7, 12681 Berlin
ISBN 978-92-990091-2-3
www.work-with-perpetrators.eu

Raporti u përgatit në kuadër të projektit STOPP – "Mbështetje për zbatimin e programeve për dhunuesit ndaj grave dhe dhunës në familje në Turqi dhe në Ballkanin Perëndimor".Projekti drejtohet nga Rrjeti Evropian për Punën me Dhunuesit-WWP EN në partneritet me UN Women si pjesë e programit rajonal *Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendësive: Fund Dhunës ndaj Grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi*, financuar nga Bashkimi Evropian.

Ky publikim u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e WWP EN dhe nuk pasqyron domosdoshmërish pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyron pikëpamjet e UN Women, të Bordit të vet Ekzekutiv apo të Shteteve Anëtare të Kombeve të Bashkuara. Pikëpamjet në këtë botim nuk nënkuptojnë ndonjë opinion mbi statusin ligjor të ndonjë vendi ose territori, ose të autoriteteve të tyre, ose përcaktimin e kufijve përkatës.Teksti nuk është redaktuar sipas standardeve zyrtare të botimit dhe UN Women nuk mban asnjë përgjegjësi për ndonjë gabim.

* Për Bashkimin Evropian, kjo pikëpamje është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimittë OKB-së dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.Për UN Women, referencat për Kosovën duhet të kuptohen se janë në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999).

Konteksti Rajonal dhe Rekomandimet

Përmbledhja ekzekutive paraqet rekomandimet kryesore për zhvillimin në të ardhmen të programeve për dhunuesit. Ajo bazohet në studimin rajonal të paraqitur në raportin Programet për Dhunuesit në Ballkanin Perëndimor; Shqyrtimi i Praktikave Ekzistuese dhe i Mënyrave për të Ecur Përpara.

Qëllimi i studimit ishte mbledhja e informacionit në lidhje me programet ekzistuese të dhunuesve në Ballkanin Perëndimor, karakteristikat e tyre dhe nivelin e tyre të përputhshmërisë me Standardet Evropiane të Cilësisë dhe Konventën e Stambollit. Gjithashtu, ai u përqendruanë analizimin e procesit të zbatimit të Nenit 16 të Konventës së Stambollit në secilin nga vendet.Studimi shqyrtoi 26 programe të dhunuesve dhe 21 shërbime mbështetëse për të mbijetuarat/it në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

Megjithëse situata në secilin vend është e ndryshme, gjatë studimit janë identifikuar disa tendenca të cilat nxjerrin në pah nevojën për përmirësime në aspektet e aksesit në programet për autorët e dhunës dhe sigurimin e cilësisë së tyre, përmirësimin e politikave të koordinuara dhe bashkëpunimin me shërbimet mbështetëse për gratë dhe përmirësimin e perspektivave gjinore dhe zbatimin e standardeve minimale të praktikës.

Programet për dhunuesit janë të përcaktuara me ligj në të gjitha vendet; megjithatë, zbatimi i tyre në praktikë është i pazhvilluar mirë. Masat apo sanksionet ekzistuese zbatohen rrallë dhe ka mungesë të shërbimeve të disponueshme. Në asnjë nga vendet nuk ka financim shtetëror specifik dhe të qëndrueshëm për programet e dhunuesve. Në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, shumë programe u zhvilluan si një mënyrë për t'i shtuar ato në fushën e veprimtarisë së profesionistëve tashmë të punësuar në disa shërbime shtetërore dhe jo si një shërbim i specializuar.Kornizat kombëtare në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi pasqyrojnë një qasje klinike në vend të një qasje të informuar gjinore ndaj dhunës.Programet u janë caktuar qendrave të shëndetit mendor dhe zbatohen kryesisht në frymën e praktikës së shëndetit mendor, veçanërisht në Mal të Zi.

Llojshmëria e programeve në rajon është e ulët, për sa i përket mënyrave aktuale të regjistrimit në programe si dhe aksesit të programeve për lloje të ndryshme klientësh. Programe specifike në kontekstin e burgjeve nuk ekzistojnë, përveç nismave pilot në Serbi dhe punës së iniciuar nga OJQ-të në Shqipëri. Programe specifike për dhunuesit seksualë, siç përvijohet në Nenin 16 të Konventës së Stambollit, gjithashtu nuk ekzistojnë. Nuk ka asnjë qasje apo program specifik për lloje të tjerë dhunuesish, si abuzuesit seksual të fëmijëve, femrat dhunuese dhe dhunuesit në marrëdhënie të tjera të dhunës në familje.

Vendet kanë bërë pak në drejtim të garantimit të cilësisë së punës me dhunuesit. Standardet janë miratuar vetëm në Maqedoninë e Veriut, ndërsa në Serbi dhe Shqipëri standardet ekzistuese nuk janë miratuar. Në Mal të Zi janë hartuar Udhëzimet për Zbatimin e Masave Mbrojtëse të Trajtimit të Detyrueshëm Psikosocial, duke krijuar kështu një burim të vlefshëm; megjithatë, ato janë më shumë një sërë udhëzimesh për profesionistët sesa standarde aktuale. Organizatat që punojnë në terren kanë bashkuar përpjekjet e tyre në rrjetet kombëtare në Serbi dhe Shqipëri, ndërsa roli i tyre në procesin e sigurimit të cilësisë ende nuk njihet. Në asnjë vend nuk ka vlerësim sistemik të programeve, përveç nismave të bazuara në projekte të disa OJQ-ve.

Përmirësimi i aksesueshmërisë së programeve për dhunuesit dhe sigurimi i cilësisë së tyre janë hapa të nevojshëm për zhvillimin e mëtejshëm të programeve për dhunuesit në rajon. Këta hapa duhet të udhëhiqen nga institucionet qeveritare përkatëse, pasi shteti luan një rol vendimtar në përcaktimin e kuadrit ligjor në çdo vend. Rekomandimet kryesore në këtë aspekt janë:

- Zhvillimi i programeve për dhunuesit si shërbime të specializuara, duke përfshirë caktimin e burimeve specifike dhe të qëndrueshme të financimit (jo vetëm shtesa në fushën ekzistuese të veprimtarisësë disa profesionistëve apo institucioneve).
- Shtetet duhet të garantojnë që programet tëcaktohen në sektorët më të përshtatshëm, që të mundësohet zbatimi i tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare të praktikës së sigurt.
- Ka nevojë urgjente për të rritur numrin e programeve të disponueshme në rajon.
- Programet që ofrohen në burgje duhet të kalojnënga niveli i veprimtarive të përgjithshme korrektuese në nivelin e programe specifike që trajtojnë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.
- Zhvillimi i programeve specifike për dhunuesit seksual.
- Zhvillimi i programeve/qasjeve specifike për të punuar me lloje të tjerë dhunuesish, si abuzuesit seksual të fëmijëve, femrat dhunuese dhe dhunuesve në marrëdhënie të tjera.
- Hartimi/miratimi i standardeve kombëtare dhe mekanizmave për monitorimin e zbatimit të tyre.
- Krijimi i vlerësimit sistemik të programeve të dhunuesve.
- Kuadri ligjor duhet të përfshijë të gjithë aspektet e përmendura më sipër.Ai gjithashtu duhet të ofrojë alternativa të ndryshme referimi për në programet e trajtimit të dhunuesve.

Programet e autorëve të dhunës në rajon nuk e kanë gjetur ende vendin e tyre në reagimin e koordinuar të komunitetit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.Shpesh, bashkëpunimi reduktohet në referime, në vend të punës së përbashkët në nivele operative dhe strategjike.Nuk ka bashkëpunim të ngushtë ndërmjet programeve të dhunuesve dhe shërbimeve të tjera të specializuara që punojnë me abuzuesit e substancave narkotike ose problemet e shëndetit mendor. Edhe pse në disa vende (Maqedoni e Veriut, Kosovë, Mali i Zi) ekzistojnë mekanizma referimi për dhunuesit që përballen edhe me abuzimin me substancat, këto programe duket se janë të kufizuara në trajtim mjekësor pa u fokusuar në shkaqet e dhunës.

Nivelet e bashkëpunimit me shërbimet mbështetëse të grave ndryshojnë sipas vendeve. Nivelet më të larta të bashkëpunimit janë të pranishme në kontekstet ku programet krijohen nga OJQ-të që mbështesin gratë, si Shqipëria, pjesë të Bosnjës Hercegovinës dhe pjesë të Maqedonisë së Veriut. Në Serbi, ky bashkëpunim është i kufizuar në disa qytete, ndërsa në Kosovë dhe Mal të Zi zhvillohet në një nivel më të përgjithshëm (për shembull bashkëpunimi në veprimtari ndërgjegjësimi), dhe jo në fushën e punës me dhunuesit.

Elementi kryesor i bashkëpunimit me shërbimet mbështetëse të grave është vendosja e kontaktit të sigurt dhe mbështetje për të mbijetuarat në kontekstin e kohëzgjatjes së zbatimit të programit për dhunuesit. Ka pasur vetëm disa praktika ku ky bashkëpunim është përcaktuar qartë dhe janë hartuar rolet dhe përgjegjësitë e secilës organizatë/profesionist.

Përmirësimi i politikave të koordinuara dhe bashkëpunimit me shërbimet mbështetëse të grave në rajon është një nga detyrat kryesore për zhvillimin e programeve në të ardhmen. Rekomandimet kryesore në këtë aspekt janë:

- Secili vend duhet të zhvillojë një kornizë gjithëpërfshirëse për bashkëpunimin ndërmjet programeve për dhunuesit dhe palëve të tjera të interesuara.Programet për dhunuesit duhet të përfshihen në punën e grupeve kombëtare të koordinimit ndaj dhunës në familje në vendin përkatës.
- Krijimi i bashkëpunimit të ngushtë me shërbime të tjera të specializuara që punojnë me abuzuesit e substancave narkotike ose persona me probleme të shëndetit mendor.
- Bashkëpunimi me shërbimet mbështetëse të grave duhet të forcohet, veçanërisht në rastet e Serbisë, Kosovës, Malit të Zi dhe disa zonave të Bosnjës dhe Hercegovinës ku programet nuk drejtohen nga OJQ-të e grave.
- Hartimi i procedurave të qarta për kontaktimin dhe mbështetjen e të mbijetuarave; kjo është një nevojë urgjente në të gjitha vendet e rajonit. Programet ekzistuese duhet të rishikojnë praktikat e tyre, të hartojnë dhe zbatojnë procedurat për kontaktimin e të mbijetuarave në çdo rast.

Megjithëse praktikat ndryshojnë ndërmjet organizatave dhe vendeve, në shumë raste ka mungesë të perspektivës gjinore, ndërkohë që perspektiva klinike ose psikoedukative është dominuese. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në nivelin e zbatimit të programit dhe kurrikulës së tij. Shumë programe deklarojnë se kanë përfshirë në punën e tyre role gjinore, stereotipe dhe maskulinitete. Ka disa programe që nuk trajtojnë këto çështje dhe fokusohen më shumë ose vetëm në menaxhimin e zemërimit, stresit dhe komunikimit jo të dhunshëm.

Praktikat e identifikuara për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në rajon janë çështje shqetësuese. Shumica e programeve të hartuara nuk kanë procedura të standardizuara që zbatohen në çdo rast për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut. Shumë programe nuk përdorin metoda të bazuara në evidenca për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, ndërkohë që disa të tjerë nuk përfshijnë perspektivën e të mbijetuarës/it. Si një metodë për të vlerësuar dhe menaxhuar riskun, disa programe përdorin testime dhe mjete psikologjike, në vend të procedurave më gjithëpërfshirëse të vlerësimit të riskut të bazuara në evidenca. Disa mbështeten në vlerësimin e riskut nga palë të tjera të interesuara, duke neglizhuar natyrën dinamike të tij.

Shumë organizata në rajon bëjnë kryesisht punë individuale me dhunuesit, ndërsa disa të tjera ofrojnë punë ekskluzivisht individuale. Potencialet e punës në grup për nxitjen e ndryshimit nuk përdoren sa duhet, si rrjedhojë e numrit të ulët të autorëve të dhunës të referuar në programe, mungesës së burimeve, programit apo trajnimit, apo hezitimeve për shkak të qëndrimeve të meshkujve ndaj punës në grup. Shumë pohuan se programet në grup për dhunuesit ishin mjaft të shkurtra, pasi ato përfshijnë 12 seanca në grup në Shqipëri dhe 16 seanca në grup në Maqedoninë e Veriut dhe në zona të Bosnje-Hercegovinës.[1] Duke ditur se sa të rrënjosura janë dogmat që mbështesin sjelljen e dhunshme, vihet në dyshim nëse këto programe të shkurtra mund të arrijnë ndryshime afatgjata.

1 Kjo i referohet numrit të seancave në grup, jo kohëzgjatjes së të gjithë programit.Programet zakonisht kanë 2-4 seanca individuale në fazën e pranimit, përpara punës në grup.

Ka nevojë urgjente për përmirësimin e perspektivës gjinore dhe zbatimin e standardeve minimale të praktikës. Rekomandimet kryesore në këtë fushë janë:

- Perspektiva gjinore duhet të zbatohet në të gjitha nivelet e programit.Ajo duhet të mbështesë kurrikulat për punën (përsa i përket temave thelbësore, parimeve), trajnimin e stafit, kompozimin e ekipeve mbështetëse (ndihmës meshkuj dhe femra) dhe qasjen në punën me klientët meshkuj dhe/ose femra.
- Programet duhet të mbështeten për të përcaktuar qartë dhe për t'iu përmbajtur kritereve të standardeve të praktikës së sigurt, dhe që gjithashtu marrin parasysh burimet dhe kompetencat aktuale të tyre.
- Të gjitha programet duhet të analizojnë praktikën e tyre nga perspektiva e riskut dhe të bëjnë ndryshimet e nevojshme. Rekomandohet fuqimisht që çdo program të hartojë dhe miratojë procedura të standardizuara rreth riskut, ose edhe më mirë, procedura në nivel vendi nëpërmjet standardeve ose protokolleve. Këto procedura duhet të bazohen në gjykimin strukturor profesional si një qasje e pranuar gjerësisht në këtë fushë, të përfshijnë perspektivën e të mbijetuarës /it dhe të përdorin një nga instrumentet e riskut të bazuar në evidenca (si SARA, DASH).
- Programet për dhunuesit inkurajohen të zbatojnë punën në grup me dhunuesit dhe të rrisin kohëzgjatjen e programeve për të arritur efekte afatgjata.

Rekomandime specifike për vendin: Kosova

Qasja në programet për dhunuesit në Kosovë është në nivel shumë të ulët, e kufizuar vetëm në dy ofrues të shërbimeve, në mjediset e OJQ-ve. Roli i shtetit duhet të jetë shumë më i spikatur në zhvillimin e kornizës dhe burimeve për punën cilësore me dhunuesit, që do të jetë një proces afatgjatë. Programet ekzistuese përballen me shumë sfida për sa i përket qëndrueshmërisë së tyre, por edhe sigurisë dhe cilësisë së punës, dhe duhet të mbështeten për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve.

Duke qenë se ka shumë aspekte që kanë nevojë për vëmendje, rekomandohet që të hartohet një strategji dhe një plan veprimi për zhvillimin e programeve për dhunuesit në vend, ose përfshirja e tyre në dokumentet ekzistuese strategjike përkatëse. Është inkurajuese që Strategjia e re Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026) përcakton krijimin dhe zbatimin e programeve për trajtimin psikosocial të autorëve të krimeve të dhunshme në objektivin specifik I.4. Megjithatë, ky proces duhet të shqyrtohet më në detaje dhe të përfshijë rekomandimet e këtij studimi.

Rekomandimet kryesore janë si në vijim:

- **Rritja e numrit të ofruesve të shërbimeve në mbarë vendin.** Programet për dhunuesit duhet të krijohen në mbarë vendin, të paktën në çdo rajon, ose në çdo qytet të madh të vendit.
- **Krijimi i burimeve njerëzore që do të ofrojnë programet.** Ka mungesë të profesionistëve të trajnuar për ofrimin e programeve për dhunuesit. Edhe në komunitetet që ofrojnë programe (Prishtinë dhe Gjakovë), numri i profesionistëve të trajnuar është shumë i ulët dhe ky aspekt duhet të forcohet. Rekomandohet fort që trajnimi të mbështetet në dispozitat e Konventës së Stambollit dhe standardet ndërkombëtare për punë cilësore. Meqenëse ekspertiza ekzistuese në vend është e kufizuar, kjo ndoshta do të kërkojë bashkëpunim me programe ose ekspertë ndërkombëtarë.
- **Përcaktimi i financimit specifik të qëndrueshëm.** Duhet të krijohen financime specifike dhe të qëndrueshme për programet, në një mënyrë që të mos ndikojë në burimet e financimit për të mbijetuarat/it e dhunës. Megjithatë, rekomandohet fort që financimi të shoqërohet me programe cilësore të provuara dhe në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare/kombëtare. Financimi duhet të përfshijë gjithashtu punën e shërbimeve mbështetëse për të mbijetuarat/it që lidhen me programet e dhunuesve.
- **Zhvillimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë në vend.** Rekomandohet hartimi i standardeve kombëtare për punën me dhunuesit me në qendër të mbijetuarit, të cilat do të përcaktojnë kriteret, por edhe do të drejtojnë punën e organizatave. Monitorimi i zbatimit të standardeve mund të zhvillohet duke ngritur një proces akreditimi, i cili duhet të jetë specifik për punën me dhunuesit (jo për këshillim të përgjithshëm apo shërbime sociale). Vlerësimi i programeve duhet të jetë i integruar në standarde dhe duhet të jetë mbarëkombëtar, duke aplikuar të njëjtën metodologji dhe të njëjtat instrumente.
- **Përmirësimi i cilësisë së programeve për dhunuesit.** Programet ekzistuese duhet të mbështeten për të përmirësuar shërbimin e tyre dhe të zgjerohen me ndërhyrjet për ndryshimin e sjelljes në praktika të sigurta, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ka boshllëqe të konsiderueshme në qasjen për kontaktimin dhe mbështetjen e të mbijetuarës/it që kanë të bëjnë me programet për dhunuesit dhe vlerësimin e menaxhimin e riskut. Gjithashtu, puna në grup me dhunuesit duhet të krijohet, inkurajohet dhe të mbështetet me trajnimet përkatëse. Rekomandohet që kurrikulat e programeve ekzistuese të analizohen nga ekspertë të jashtëm, në mënyrë që të jepen rekomandime për përmirësimin

e tyre. Është gjithashtu e rëndësishme që ofrimi i ngritjes së kapaciteteve në të ardhmen të mos kufizohet vetëm në trajnime, por të ofrojë mbështetje të vazhdueshme përmes mentorimit dhe mbikëqyrjes së jashtme.

- **Zhvillimi i programeve në mjedisin e burgut.** Duhet të zhvillohen programe specifike për mjedisin e burgut dhe të planifikohet zbatimi i tyre në të gjithë vendin.
- **Zhvillimi i shërbimeve për dhunuesit seksual dhe lloje të tjerë klientësh (si femrat dhunuese, autorë të dhunës në familje).** Çdo kategori klientësh kërkon një program specifik që duhet të zhvillohet. Megjithatë, duke pasur parasysh që programet për dhunën ndaj partnerit intim janë të pazhvilluara mirë, rekomandohet që këtyre programeve t'u jepet përparësi dhe në fazat e mëvonshme fokusi të vihet në lloje të tjerë klientësh.

The European Network for the Work with Perpetrators of Domestic Violence (WWP EN)

Founded in 2014, the European Network for the Work with Perpetrators of Domestic Violence (WWP EN) is a membership organisation with members including perpetrator programmes, research institutes, and victim/survivor support services. Today, we unite over 60 members across Europe for a common goal: accountable, effective, and victim-centred perpetrator work.

We believe that gender-based violence violates women's human rights and aim to create a gender equitable world by supporting member organisations in their work with those who choose to use violence in intimate partnerships, predominantly men.

As an umbrella organisation, WWP EN supports its members in offering and developing responsible, victim-focused perpetrator work. As part of our capacity-building, we offer innovative and essential training for perpetrator programmes. Additionally, we work to promote the Istanbul Convention together with a growing network of European and global partners.

To build a European dataset on the effectiveness of perpetrator work and support perpetrator programmes in showing their positive impact, WWP EN offers the IMPACT Outcome Monitoring Toolkit.

www.work-with-perpetrators.eu